



Pranimar / Dorezuar Prenjshëm/Prudato Received/Delivered	22-09-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPNSHICK	5622	2022	115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.693/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.693/2022 të datës 09.08.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë të Komunës së Deçanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.693/2022 e datës 09.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.02/Zyrtarisht i datës 09.08.2022 i Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë i Komunës së Deçanit.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 09.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4612/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë i Komunës së Deçanit me numër 02/ Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim , me pretendimin se Komisioni Vlerësues nuk e ka marrë për bazë ankesën dhe nuk e kanë ftuar ta rishikoj testin e vlerësimit dhe se komisioni ka ndikuar në rezultatin final.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë në Komunën e Deçanit. Më datë 23.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Deçanit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokoli 4612/2022 të datës 09.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë i Komunës së Deçanit me numër 02/Zyrtarisht i datës 09.08.2022; Konkurs lëvizje brenda kategorisë i datës 24.06.2022; Ankesë e ankuesit me numër 02-27738 drejtuar Komisionit Vlerësues i datës 03.08.2022; E-mail nga D.H. për ankesa.kpmsnck@rks-gov.net i datës 09.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.08.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 4918/2022 i datës 23.08.2022; Pliko me numër R2520433 i datës 17.08.2022; Renditja përfundimtare e datës 29.07.2022; Njoftim për përfshirje në listë të ngushtë për kandidatin Sh.G i datës 06.07.2022; Njoftim për përfshirje në listë të ngushtë për kandidatin D.H. i datës 06.07.2022; Njoftim për përfshirje në listë të ngushtë për kandidatin A.D. i datës 06.07.2022; Njoftim për kandidatin e suksesshëm nr.02/Zyrtarisht i datës 29.07.2022; Vlerësimi i aplikantëve; Akt Emërimi i D.H. i datës 02.09.2015; Diplomë e D.H. e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër nr.4249 i datës 15.04.2014; Akt Emërim i A.D. i datës 04.10.2019; Diplomë e A.D. e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër nr. 911 i datës 25.09.2015; Pliko me numër R2443394 i datës 19.08.2022; E-mail nga E.C. për C.Z. i datës 15.09.2022; Lista e aplikantëve SIMBNJ; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin D.H.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin A.D.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin A.D.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin A.D.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin A.D.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.; Formulari MAP-SHCK-08a Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin SH.G.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Komuna e Deçanit më datë 03.06.2022 ka publikuar Njoftimin për hapje të Konkursit për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009163 për pozitën e punës "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim" në Drejtorinë për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit në fazën e shqyrtimit paraprak me datë 06.07.2022 ka shpallur Njoftimin me numër RN00009163 përmes të cilit është bërë njoftimi se ankuesi ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti do të vazhdoj me procedurën e intervistës me gojë.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë sipas Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve të datës 29.07.2022 ka vlerësuar kandidatët me pikët e fituara për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Deçanit ku kandidati nuk ka arritur të merr pikët e kërkuara për të qenë kandidat fitues dhe i njëjti është renditur i treti (3) me gjithsej 84 pikë ndërsa kandidatja fituese gjithsej ka grumbulluar 95 pikë e cila është renditur e para si kandidate.

Ankuesi kundër vlerësimit të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë ka parashtruar ankesë me datë 03.08.2022 në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë, ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër nr.02/Zyrtarisht me datë 09.08.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, në intervistimin me gojë ka vlerësuar se kandidati që ka aplikuar për pozitën e lartcekur nuk ka marrë pikët për të qenë kandidat fitues.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë me Nr.02/Zyrtarisht të datës 09.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin se Komisioni Vlerësues nuk e ka marrë për bazë ankesën dhe nuk e kanë ftuar ta rishikoj testin e vlerësimit dhe se komisioni ka ndikuar në rezultatin final.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës, ka konstatuar Njësia e Burimeve Njerëzore në pajtim me nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve, ndërsa Komisioni për Lëvizje Brenda Kategorisë në kuptim të kompetencave të përcaktuar me nenin 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa vlerësimi i kandidatëve është bërë sipas kriterëve të përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë"*.

Nga vlerësimi i kandidatëve, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë 84 pikë, ndërsa kandidatja është vlerësuar me gjithsejtë 95 pikë, si rrjedhojë vlerësimi

është bërë në pajtim me dhe nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjestohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësinin përfundimtar të konkurrimit"*.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin që vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë, sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve, kandidatja ka gjithsejtë 95 pikë dhe është rendit e para atëherë sipas kësaj e njëjta ka të drejtë të emërohet në këtë pozitë në kuptim të nenit 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se: *"Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëmrisht"*.

Bazuar në këtë Kolegji, konstaton se sipas Njoftimit për kandidatin e suksesshëm me Nr.02/Zyrtarisht me datë 29.07.2022 ka shpall kandidatin fitues kandidaten me gjithsejtë 95 pikë, është nxjerr në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa edhe e gjithë procedura është zhvilluar konform legjislacionit përkatës në fuqi.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.02/Zyrtarisht përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankuesit, është nxjerr në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 50 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu ky vendim përmban elementet e aktit administrativ dhe arsyetimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.693/2022

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Eshref Shabani

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

